



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:261859

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05784914

KPPP.nr. 2037/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Din – Company” D.o.o, me numër PIB 101788686 dhe seli në Republika e Serbisë, Dositjeva 76, Novi Pazar 36300, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Fisnik Sogojeva dhe Adelina Isufi, avokat nga Prishtina, kundër debitorit “Prime Logistics” L.L.C., me numër unik identifikues 810046187 dhe seli në Prishtinë, Ulpianë, C2, H/1, nr. 2, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shkumbin Asllani dhe Edita Ismaili, avokat nga Prishtina, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 609/23, i lejuar me datë 03.11.2023, nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 05.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Prime Logistics” L.L.C., me numër unik identifikues 810046187 dhe seli në Prishtinë, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 609/23, i lejuar me datë 03.11.2023, nga Përmbartuesi Privat Rezarta Metaj, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Din – Companu” D.o.o, mbi bazën e dokumentit - Faturës nr. 141, e datës 17.03.2022 dhe Faturës nr. 218, e datës 27.04.2022, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 609/23, të datës 03.11.2023, me të cilin është urdhëruar debitori “Prime Logistics” L.L.C., që brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj shumën prej EUR 4,740.00 me kamatë prej 8%, duke filluar nga data kur kredia është bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përmbartimore si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në lartësi prej EUR 208.00, sipas tarifës së OAK-së.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi si të pabazuar urdhrin përmbarimor, me arsyetim se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbarues ose urdhri përmbarues nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, dhe se urdhri përmbarimor nuk përmban elementet thelbësore të cilat duhet t'i përmbajë një urdhër, duke qenë në kundërshtim me nenin 43 të LPP-së. Më tej, ka theksuar se zbatimi i dokumentit të besueshëm të një vendi tjetër në Republikën e Kosovës duhet t'i nënshtrohet nenit 11 të LPP-së. Ndërsa, ka shtuar se nuk është vërtetuar që faturat janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se janë pranuar nga debitori, për arsye se të njëjtave iu mungon nënshkrimi apo vula e pranimi të debitorit dhe si rrjedhojë nuk i plotësojnë kushtet për të shërbyer si dokumente të besueshme. Krejt në fund, ka theksuar se dokumentet si CMR të cilat i janë bashkangjitur propozimit nuk paraqesin dëshmi se debitori ka pranuar fatura në bazë të së cilave është lejuar urdhri dhe se është pajtuar me përmbajtjen dhe lartësinë e tyre. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të anulohet, si dhe të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbarimore.

Kreditori, përmes përfaqësuesit të autorizuar në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se nuk ka paraqitur asnjë provë dhe se nuk janë plotësuar kushtet për të cilat mund të paraqitet prapësimi. Ka shtuar se sa i përket pretendimit se përmbaruesi që ka lëshuar urdhrin për përmbarim nuk është kompetent, një pretendim i tillë është i pa bazuar pasi që kompetent për zbatimin e përmbarimit është përmbaruesi në territorin ku debitori ka vendbanimin apo selinë e tij. Më tej, ka theksuar se faturat mbi bazë të së cilave është lejuar urdhri i plotësojnë kushtet nga neni 29 i LPP-së, dhe se janë dorëzuar në origjinale ashtu që i plotësojnë të gjitha elementet për të shërbyer si dokumente të besueshme. Ndërsa, ka shtuar se fakti se debitori ka detyrim ndaj kreditorit është i pamohueshëm sepse vet debitori ka pohuar faktin se ka pranuar mallra nga kreditorit dhe se kjo vërtetohet edhe nga dokumentet transportuese CMR. Në fund, ka theksuar se propozimi për përmbarim është iniciuar në bazë të nenit 29 të LPP-së, në përputhje me nenin 38 dhe 40, andaj edhe organi përmbarimor ka vepruar drejtë kur ka lejuar urdhrin e propozuar. Për këto arsye i ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet debitori që të kompensojë shpenzimet e procedurës përmbarimore dhe atë për përpilimin e përgjigjes në prapësim në vlerë prej EUR 208.00.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të palëve, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (në tekstin e mëtejshëm: “LPP”) gjykata gjen se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së: “*Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, ndërsa, pika 1.3 e njëjtit nen ka përcaktuar faturën si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, në paragrafin 3 të këtij neni është përcaktuar se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumat dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar*”. Në anën tjetër, me nenin 37 të LPP-së parashihet se: “*Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit*”.

Gjykata, duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se Fatura nr. 141, e datës 17.03.2022 dhe Fatura nr. 218, e datës 27.04.2022, mbi bazën e së cilave është paraqitur propozimi për përmbartim dhe është lejuar urdhri përmbartimor, nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme, ngase nuk mund të vërtetohet që të njëjtat fatura janë dorëzuar në mënyrë të rregullt nga ana e kreditorit dhe se janë pranuar nga debitori, për arsye se të njëjtave iu mungon nënshkrimi apo vula e pranimet të debitorit. Në anën tjetër, kreditori nuk ka arritur të dëshmojë se në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme ia ka dorëzuar debitorit faturat objekt përmbartimi. Andaj, si të tilla, faturat mbi të cilat është lejuar urdhri përmbartimor nuk janë të përshtatshme për t’iu nënshtruar përmbartimit.

Gjykata ka vlerësuar edhe CMR-të të cilat kreditori ia ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim si dokumente ndërkombëtare për mënyrën e transportit të mallrave dhe mbi bazën e së cilave pretendon se debitori ka pranuar mallrat dhe ka qenë në dijeni për detyrimet sipas faturave, mirëpo gjeti se dokumentet mbi transportimin e mallrave (CMR) paraqesin dëshmi në raport ekzistimin e kontratës mbi transportimin e mallrave mes dërguesit dhe transportuesit, këtu kreditorit, mirëpo jo dëshmi përmes së cilës mund të arrihet në përfundim se këtu debitori ka pranuar faturat mbi bazën e së cilave është lejuar urdhri apo se është pajtuar si për nga përmbajtja ashtu edhe lartësia e detyrimit monetar që buron nga këto fatura.

Për më tepër, gjykata gjen se zbatimi i dokumentit të besueshëm të lëshuar nga një subjekt i vendit të huaj sikurse në rastin konkret, duhet t'i nënshtrohet zbatimit të dispozitave të nenit 11 të LPP-së, sipas të cilit *“Përmbarimi i dokumentit të huaj përmbarimor do të caktohet dhe zbatohet sipas këtij ligji, nëse dokumenti përmbarimor i huaj i plotëson kushtet e parapara me ligj apo marrëveshje ndërkombëtare për pranim dhe përmbarim.”*

Megjithatë, gjykata rikujton se vendosja në këtë çështje përmbarimore nuk e paragjykon të drejtën e palës kreditore që, lidhur me pretendimet për borxhin sipas faturave, të inicioj proces të rregullt kontestimor pranë gjykatës kompetente.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumentet, mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Nga sa më sipër, gjykata në kuptim të nenit 71, paragrafi 1.1 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2037/23, datë 05.06.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranim të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.